



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i *Ekonomiksit* në *Fakultetin Ekonomik* në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani” për nevojat e tij, për mbulim të nevojave të procesit mësimor, për vitin akademik 2022-2023 shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme.

Kriteret e përgjithshme e të veçanta për pozicionin e punës *personel akademik* me *kohë të pjesshme* për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) brenda ose jashtë vendit në *Shkenca Ekonomike dhe Specialitet përkatëse*. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Preferohen kandidatë me tituj e grada shkencore në specialitet e fushës. Gradat e fituara brenda ose jashtë vendit e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
3. Të ketë përvojë dhe të jetë i angazhuar në mësimdhënie në lëndët e specialiteteve në IAL publike dhe private Brenda dhe jashtë vendit.
4. Të jetë i angazhuar në kërkimin shkencor.
5. Te këtë aftësi të mira në mësimdhënie.
6. Preferohen publikime në fushën e specialitetit përkatës.
7. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi.
8. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna
9. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit te aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jahtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore(Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 14.09.2022** deri **23.09.2022**.

Adresa postare:

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani",
Rruga "Ismail Zyma",
Aplikim në Fakultetin Ekonomik
Departamenti i Ekonomiksit
Elbasan